



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

1329/17
20.11.2017

**RREGULLORE PËR NORMAT E PUNËS NË
SEKTORIN PROGRAMOR DHE PËR
BASHKËPUNËTORËT E JASHTËM TË RTK-së**

RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS

Prishtinë, Nëntor 2017

Në bazë të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve Nr.04/L-077, Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7/27 prill 2012), dhe të Statutit të RTK-së, Bordi i RTK-së miraton:

**RREGULLORE PËR
NORMAT E PUNËS NË SEKTORIN PROGRAMOR DHE
PËR BASHKËPUNËTORËT E JASHTËM TË RTK-SË**

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kriteret dhe normat për vlerësimin e përmbushjes së detyrave dhe obligimeve në bazë të Kontratave të punës në pajtim me Ligjin e punës, Kontratave për shërbime në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve dhe Ligjin për RTK-në.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore vlen për të gjithë të punësuarit që janë punëtorë të rregullt të RTK-së.

Neni 3

Vlerësimi

Vlerësimi i përmbushjes së normës së punës dhe rezultateve të arritura në punë bëhet me matjen dhe vlerësimin e vëllimit të detyrave të punës, si dhe cilësisë së zbatimit të detyrave të punës.

Neni 4

Orari i punës

4.1. Për të gjithë të punësuarit në Radiotelevizionin e Kosovës orari i punës së plotë është 40 orë në javë.

4.2. Shërbimi i produksionit dhe njësia e kamerës në studio, njësia e zërit, njësia e montazhës, njësia e grafikës dhe dizajnit, njësia e skenografisë, njësia e organizimit dhe planifikimit, janë të obliguar që të punojnë 40 orë në javë e jo më gjatë se 48 orë në javë, në të cilën duhet t'i përmbushin të gjitha detyrat e parashikuara me planin e përcaktuar.

4.3. Departamenti i realizimit dhe regjisë - duhet në nivelin mujor t'i realizojë 1 orë e gjysmë të programit dokumentar ose 8 orë të programeve kulturore, argëtuese, sportive etj., ose 14 orë të programit informativ, duke respektuar orarin e punës.

4.4. Plani i teknikës - i punësuarit, orari i punës së të cilit është i lidhur me objektet e RTK-së, duhet të plotësojë planin mujor prej 40 orë në javë.

4.5. Producentët ose organizatorët e sektorëve mbajnë evidencën e realizimit të planit mujor për të punësuarit, të cilën e dorëzojnë te udhëheqësit e departamenteve për vlerësim dhe konfirmim.

4.6. Arsyetimi për mospërbushjen e planit i dorëzohet të punësuarit dhe redaktorit të redaksisë, në të cilën i punësuarit është i sistemuar.

4.7. Nëse i punësuarit nuk është i kënaqur me arsyetimin për mospërbushjen e planit, mund të paraqesë ankesë te kryeredaktori dhe drejtori i programit në të cilën i punësuarit është i sistemuar.

Neni 5

Plani Mujor i Punës

5.1. Udhëheqësit e departamenteve janë të obliguar të angazhohen në punë 40 orë në javë, në kuadër të së cilës duhet t'i përmbushin të gjitha detyrat e parapara me planin mujor të punës.

5.2. Përmbushjen e planit mujor të punës e aprovon dhe e vlerëson drejtori i programit në të cilën udhëheqësit e departamenteve janë të sistemuar.

5.3. Arsyetimi për mospërbushjen e planit mujor të punës i dorëzohet udhëheqësve të departamenteve si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së. Nëse udhëheqësit e departamenteve nuk janë të kënaqur me arsyetimin e mospërbushjes së planit mujor të punës mund të paraqesin ankesë te Drejtori i Përgjithshëm RTK-së.

Neni 6

Matja e performancës së gazetarëve dhe redaktorëve në RTK

6.1. Matja e performancës së gazetarëve dhe redaktorëve në RTK.

Tabela

EMRI:	PIKË – ORA
Lajm i shkurtër – off	2 – 4
Raport – Kronikë	6 – 10
Deklaratë/Anketë	4 – 6
Temë	deri 10
Temë hulumtuese	deri 20
Intervistë e shkurtër	6 – 8
Intervistë	deri 12
Reportazh në kuadër të emisionit	deri 16
Reportazh - emision	deri 40
iRaport (storia finale me pajisje të mençur)	deri 10
Përmbledhje (ngjarje të veçanta)	deri 25
Emisioni i drejtpërdrejtë/xhiruar	deri 40

Dokumentar	deri 160
Bashkëpunimi në emision	deri 8
Raportimi i drejtpërdrejt nga Kuvendi	deri 10
Raportimi i drejtpërdrejt nga ngjarjet e tjera	deri 10
Raportimi i drejtpërdrejt nga ngjarjet me rrezikshmëri	deri 20
Komentimi i ndeshjeve sportive	deri 25
Moderimi i emisioneve	deri 12
Komentimi nga ngjarjet e rëndësishme (koncerte, Oscar, Brit Aëard's etj.)	deri 25
Redaktim i lajmeve të ditës/mbrëmjes	3
Redaktim i lajmeve të ditës/mbrëmjes - RTK 2 TV lajmeve	4
Redaktim i ditarëve- RTK 2 TV	deri 13
Redaktim i lajmeve qendrore	deri 13

6.2. Norma mujore e punës për gazetarë dhe redaktorë në RTK është 160 pikë.

Neni 7

Raporti i Plotësimit të Normës

Producentët dhe organizatorët janë të obliguar që për çdo muaj të dorëzojnë raportin e plotësimit të normës.

Neni 8

Matja e performancës së gazetarëve në RTK Radio

8.1. Matja e performancës së gazetarëve në RTK Radio.

Tabela

Nr.	ZHANRI	PIKË-ORA
1.	Lajm	
2.	Anketë	3
3.	Bisedë	2 - 4
4.	Intervistë	3-5
5.	Raport	deri 8
6.	Emision i drejtpërdrejtë/incizuar	deri 6
7.	Bllok programor	8-10
8.	Transmetim nga kuvendi	1- 3 orë 2-6
9.	Kronika sportive	deri 10
10.	Komentim/sport	5-10
11.	Redaktim i lajmeve të ditës/mbrëmjes	10-15
12.	Dokumentar	8
13.	Temë	deri 40
14.	Teme hulumtuese - emision	deri 10
15.	Raportimi i drejtpërdrejtë nga ngjarjet e tjera	deri 20
16.	Raportimi i drejtpërdrejt nga ngjarjet me rrezikshmëri	deri 10
		deri 20

8.2. Norma mujore e punës së gazetarëve në RTK Radio është 160 pikë.

Neni 9

Matja e performancës së xhiruesve në RTK – TV

9.1. Matja e performancës së xhiruesve në RTK – TV.

Tabela

EMRI:	PIKË – ORA
Lajme-ngjarje ditore	3
Raport	4
Deklaratë/Anketë	2-4
Kronikë/ tema e ditës / Analiza	deri 8
Përgatitja e rubrikës/emisionit	2 – 4
Intervistë	4 - 8
Reportazh	deri 16
Kycje e drejtpërdrejtë	2 - 4
Kycje e drejtpërdrejtë nga ngjarjet me rrezikshmeri	deri 20
Dokumentar	deri 80

9.2. Norma mujore e punës për xhirues është 160 pikë (orë).

9.3. Udhëheqësi i njësisë së xhiruesve është përgjegjës për evidentimin e përditshëm të performancës, të cilën e dërgon te Udhëheqësi i Produksionit për vlerësim dhe konfirmim.

Neni 10

Zhanret e veçanta

Në këtë rregullore nuk janë të përfshira zhanret e veçanta të cilët kërkojnë një përgatitje më të detajuar, vlerësim dhe analizë, tema të veçanta, transmetimi i ngjarjeve të jashtëzakonshme. Në këto raste vlerësimi i përmbushjes së detyrave bëhet nga Kryeredaktori/ja ose Udhëheqësi i Njësisë.

Neni 11

Sukseset në Punë

Suksesi në kryerjen e punëve e të gjithë të punësuarve në RTK, përveç drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, menaxhmentit, kryeredaktorit, redaktorit përgjegjës, dhe producentit ekzekutiv, përcaktohet në bazë të matjeve, krahasimeve dhe vlerësimeve të vëllimit të punëve të kryera dhe cilësisë së punëve të kryera.

Neni 12

Vlerësimi i përmbushjes së detyrave të punës

Bazat dhe kriteret për vlerësimin e përmbushjes së detyrave të punës janë si në vijim:

1. Raporti në mes objektivave të punës dhe planifikimit.
2. Raporti në mes vëllimit të detyrave të punës të planifikuara dhe të kryera.
3. Respektimi i afateve të caktuara për kryerjen e punëve të planifikuara.
4. Intensiteti i punës lidhja mes orëve efektive të punës dhe prania në punë.

Neni 13

Vlerësimi i cilësisë së punëve të kryera

Bazat dhe kriteret për vlerësimin e cilësisë së punëve të kryera janë kualiteti i punës së kryer, kreativiteti ose autorësia, pavarësia dhe iniciativa e të punësuarit, si dhe rrezikshmëria.

Neni 14

Vlerësimi i performancës së gazetarëve dhe redaktorëve

14.1. Vlerësimin e performancës së gazetarëve dhe redaktorëve e konstaton Redaktori përgjegjës, respektivisht Producenti ekzekutiv, e miraton Kryeredaktori dhe e aprovon Drejtori i Televizionit/Radios.

14.2. Të punësuarit, të cilët vërtetohet që kanë përmbushur rezultate të veçanta në punë, në bazë të kriterëve nga neni 11 dhe neni 12 i kësaj Rregulloreje, do të shpërblehen në bazë të Rregullores për kompensim/shpërblim për të punësuarit në RTK.

Neni 15

Honorarët e korrespondentëve / bashkëpunëtorëve

Çmimorja për honorarët e korrespondentëve si më poshtë.

- lajmi 5 euro;
- lajmi i zgjeruar 7 euro;
- raporti 10 euro;
- raporti telefonik për korrespondentët jashtë Kosovës (Rajon) prej 10 € deri në 30€.
- Storie e incizuar, e montuar dhe e gatshme për transmetim nga bashkëpunëtorët në Kosovë dhe në rajon - 50 €- 100 €.
- Storie e incizuar, e montuar dhe e gatshme për transmetim (Evropë; SHBA; dhe kontinentet e tjera prej 100 € deri në 300 €)
- Asistimi teknik nga korrespondentët (studio, kamera montazhi) 15€ - 25€ (Evropë; SHBA; dhe kontinentet e tjera 100 €).

Neni 16
Shpenzimet e tjera për korrespondentë

Për korrespondentët në BE (përfshirë Beogradin, Sarajevën dhe Stambollin), SHBA dhe kontinentet e tjera, kompensim shtesë për shpenzimet e tjera në muaj, në BE deri në 1200 €, në SHBA dhe kontinentet e tjera deri në 2000 € .

Neni 17
Honorarët artistikë

17.1. Honorari dhe pagesa për përgatitjen e regjisë, për:

- serial televiziv - çmimi deri në 700 € për episod;
- film televiziv çmimi deri në 3.000 €;
- film dokumentar, çmimi deri në 1.500 €;
- emision dokumentar çmimi deri në 700 €;

17.2. Honorari dhe pagesa për përgatitjen e skenarit, për:

- seriali televiziv çmimi deri në 600 € për episod;
- film televiziv çmimi deri në 2.000 €;
- film dokumentar, çmimi deri në 1.000 €;
- emision dokumentar çmimi deri në 600 €;

17.3. Honorari dhe pagesa për angazhimin e aktorëve:

- roli kryesor në serial, çmimi deri në 500 € për episod;
- roli dytësor në serial, çmimi deri në 300 € për episod;
- rol episodik në serial, çmimi deri në 150 € për episod;
- roli kryesor në film, çmimi deri në 1.500 €;
- roli dytësor në film, çmimi deri në 1.000 €;
- rol episodik në film, çmimi deri në 300 €;

17.4. Honorari dhe pagesa për sinkronizimi i një emisioni prej 15 € deri në 50 €.

17.5. Honorari dhe pagesa për angazhimin bashkëpunëtorëve të jashtëm:

- bashkëpunëtor i jashtëm profesional një emision deri në 150 €;

- moderator një emision deri në 100 €;
- gazetar në emision deri në 150 €;

17.6. Programet argëtuese: regjia deri në 2.000 €, skenari deri në 1.500 €, moderimi deri në 1.000 €, xhirimi i ndeshjeve sportive deri në 50 € dhe komentimi i ndeshjeve sportive deri në 50 €.

17.7. Programet muzikore, moderimi deri në 200 €, ndërsa instrumentalistët deri në 500 €.

17.8. Honorari dhe pagesa për angazhimin në programet kulturore për bashkëpunëtor të jashtëm profesional - një emision deri në 500 €, për moderimin e një emisioni deri në 250 € dhe për gazetar në emision deri në 300 €;

17.9. Honorari dhe pagesa për angazhimin në emisionin dokumentar për bashkëpunëtor të jashtëm profesional një emision deri në 700 €, dhe për moderimin e një emisioni deri në 250 €, ndërsa gazetar në emision deri në 350 €;

17.10. Honorari dhe pagesa për angazhimin në emisionet debutuese për bashkëpunëtor të jashtëm profesional një emision deri në 1000 €, moderimi i një emisioni deri në 250 €, gazetar në emision deri në 350 €, analistë profesionalë në emisione debatuese deri në 100 € për emision.

Neni 18

Bashkëprodhimi

Çështja e bashkëprodhimit të emisioneve do të rregullohet nga rasti në rast, varësisht nga oferta, duke respektuar të gjitha procedurat sipas rregulloreve gjegjëse dhe Ligjit për RTK-në.

Neni 19

Përkthimi

Honorari dhe pagesa për përkthime, për emision dokumentar deri në 30 minuta 30 €, emision dokumentar shkencor deri në 30 minuta 40 €, emision informativ deri në 30 minuta 50 €, emision dokumentar deri në 60 minuta 70 €, emision dokumentar shkencor deri në 60 minuta 80 €, emision informativ deri në 60 minuta 100 €, film artistik deri në 100 €, serial – një episod deri në 30 minuta deri në 30 €, serial – një episod deri në 60 minuta deri në 40 €, përkthimi simultan për një emision deri në 10 minuta 20 €, përkthimi simultan për një emision prej 10 deri në 60 minuta 50 €, përkthimi i dokumentacionit/shkresave të ndryshme 8 € deri më 10 € për një faqe.

Neni 20

Inicimi i ndryshimit të rregullores

Iniciativa për ndërrimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mund të iniciohet nga

drejtorët e kanaleve televizive dhe të radios, udhëheqësit e Shërbimeve të Përbashkëta dhe Drejtori Gjeneral i RTK-së.

Neni 21

Dispozitat kalimtare

Të gjithë të angazhuarit, të cilët nuk janë të përfshirë në normim, por që kryejnë shërbime në bazë të angazhimeve, do të kompensohen ekuivalent me pozitat të cilat janë të vendosura në Katalogun e vendeve të punës në RTK.

Neni 22

HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 20 Nëntor 2017

Bordi i RTK-së, Afërdita Maliqi, kryetare


